

AKT - THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA

“MBJESHOVA 2011” SH.P.K..

Sot, më 06.07.2011, në Berat, Unë Ortaku Themelues GEZIM MEDULAJ, i biri i Ramisit, i datëlindjes 8 Korrik 1972, identifikuar me dokumentin ID 025789390, banues në Fshatin Mbjeshove të Komunes Sinje të rrethit Berat, në bazë të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërit Tregtare” si dhe ligjit Nr.9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” me vullnetin tim të lirë, hartoj Akt -Themelimin e Shoqërisë Tregtare “MBJESHOVA 2011” sh.p.k. si më poshtë vijon:

FORMIMI I SHOQËRISË

Neni 1

Themelohet shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**MBJESHOVA 2011**” sh.p.k.

Shoqëria e zhvillon veprimtarin e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi, tregtar, doganor, tatimor, dhe aktet e tjera ligjore e nën ligjore në fuqi, sipas objektit të veprimtarisë së saj mbi bazën e këtij akti dhe statutit të saj dhe normat e së drejtës tregtare ndërkombëtare.

Shoqëria fiton personalitetin juridik nga data e regjistrimit të saj në Qendrën kombëtare të Regjistrimit.

QËNDRA, TERRITORI

Neni 2

Selia e shoqërisë “MBJESHOVA 2011” sh.p.k. ndodhet në Fshatin Mbjeshove (pranë shkolles 9-vjecare) të Komunes Sinje të rrethit Berat.

Shoqëria mund të hapë edhe filiale, përfaqësi, agjensi operative në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Me miratim të organeve kompetente shtetërore, shoqëria, mund të hapë edhe filiale, degë, përfaqësi, agjensi të saj edhe jashtë vendit.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë tregtare “MBJESHOVA 2011” sh.p.k, do të jetë me afat të pacaktuar dhe mbi 10 vjet, duke filluar ky afat nga dita e regjistrimit të shoqërisë si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.



Ajo mund të shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak, duke kryer më parë të gjitha veprimet e likuidimit sipas dispozitave ligjore në fuqi.



OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 4

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "MBJESHOVA 2011" sh.p.k. ne Fshatin Mbjeshove te Komunes Sinje te rrethit Berat, do të jetë:

1. Tregtim i mallrave ushqimore, pijeve freskuese dhe alkolike me shumic e pakic.
2. Tregtim i metaleve dhe materialeve te ndertimit me shumic e pakicë.
3. Tregtim i materialeve te ndryshme hidrosanitare, elektroshtepijake, vajrave e lubrifikanteve, pjeseve te kembimit dhe pajisjeve kompjuterike me shumic e pakic.
4. Prodhim, perpunim e tregtim i mineraleve te gurit dhe mermerit me shumic e pakic.
5. Tregtim dhe perpunim i lendes drusore dhe duraluminit.
6. Sherbime ne fushen e Turizmit, Restoranteve dhe Bar-Kafes.
7. Sherbimi i transportit per udhetare e mallra, brenda e jashtë vendit per vehte dhe te trete.
8. Import -- Export.

Për kryerjen e veprimtarisë së saj, shoqëria do të hap njësi prodhimi, shërbimi, tregtimi dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë e juridik vendas dhe të huaj.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.000.000 (Tre million) lekë dhe është kontribut i ortakut të vetëm themelues të shoqërisë. Kapitali themeltar eshte kontribut i ortakut te vetem themelues z. Gezim Medulaj dhe perbehet: ne mjete monetare ne vleren 2.530.000 (dy million e peseqinde e tridhjet mije) leke dhe ne natyre ne vleren 470000 (katerqinde e shtatedhjet mije) leke. Kontributi ne natyre perbehet: Autoveture me vlere 250000 leke, Pirune me vlere 128000 leke dhe Makineri per prerjen e gurit me vlere 92000 leke.

Kapitali themeltar eshte i ndarë në 3.000 kuota me vlere nominale 1000 (nje mijë) lekë per kuote.

Kuotat e kapitalit themeltar zoterohen teresisht nga ortakut i vetem themelues i shoqerise z. Gezim Medulaj.

Kapitali themeltar mund të shtohet ose të pakësohet sipas vendimit të ortakut themelues.

Kapitali është tërësisht i shlyeshëm dhe i nënshkruar.

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie, por ato mund t'u transferohen personave të tretë, që nuk bëjnë pjesë në ortakëri, por gjithmonë me vendim të ortakut të vetëm themelues dhe me akt noterial, konform ligjit.

Fitimi që do të realizohet gjatë veprimtarisë ekonomike të shoqërisë do të administrohet nga ortakët i vetëm themelues. Një pjesë e këtij fitimi do të përdoret për investime dhe zgjerimin e aktivitetit tregtar.

Ky fitim do të disponohet lirisht prej ortakut të vetëm, pasi shoqëria të ketë shlyer më parë detyrimet ligjore.

Për kryerjen e veprimtarisë së saj, shoqëria do të hap njësi prodhimi, shërbimi, tregtimi dhe do të bashkëpunojë me persona fizikë e juridik vendas dhe të huaj.

Shoqëria mund të ushtrojë dhe aktivitete të tjera në përputhje me legjislacionin në fuqi, të konsideruara me përfitim dhe të dobishme për arritjen e objektivave të saj kryesore.

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

Neni 6

Ortakët i vetëm themelues është organi më i lartë drejtues dhe vendimor i shoqërisë, ai ushtron të gjitha kompetencat i jep ligji "Për tregtarët dhe shoqërit tregtare", i njeh asamblesë së ortakëve që janë krijuar me ortakëri. Pra, ortakët i vetëm themelues ka të gjitha të drejtat që ka asambleja e ortakëve.

Ortakët i vetëm themelues mund t'ia delegojë kompetencat një ose më shumë administratorëve të emëruar prej tij ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokurës noteriale.

Ortakët i vetëm themelues i shoqërisë, emëron si Administrator të shoqërisë "MBJESHOVA 2011" sh.p.k. z. Gezim Medulaj, me afat për 5 (pesë) vjet, afat i cili fillon menjëherë me regjistrimin e shoqërisë si person juridik në Q.K.R.

Marrëdhëniet me të tretët shoqëria i ndërton mbi bazën e reciprocitetit dhe kontratës, sipas kërkesave dhe objektivit të saj, konform legjislacionit në fuqi.

Marrëdhëniet juridike midis shoqërisë dhe të punësuarve do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punës në përputhje me Kodin e Punës dhe ligjet në fuqi.

Llogaritë vjetore të shoqërisë mbahen nga kontabilist të miratuar i cili emërohet nga administratori i shoqërisë, i cili mund të shkarkohet edhe nga ortakët i vetëm themelues i shoqërisë.

Kontrolli i llogarive vjetore të shoqërisë kryhet nga ekspertë kontabël të autorizuar dhe emërohet e shkarkohet nga ortakët i vetëm themelues i shoqërisë.

Çdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor.

Përrjashtimisht viti i parë financiar ka filluar ditën e themelimit si person juridik.

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 7

Shoqëria do të ketë vulën e saj. Vula duhet të mbajë stemën dhe shkrimet e nevojshme që tregojnë emrin e shoqërisë.





Neni 8

Për të gjitha çështjet që nuk parashikohen në këtë Akt –Themelim dhe në Statutin e shoqërisë, do të zbatohen dispozitat e Kodit Civil dhe dispozitat ligjore të ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqërit Tregtare”.

Për të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të kësaj shoqërie do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërtën kur mosmarrëveshjet nuk zgjidhen me mirëkuptim, organi kompetentë për zgjidhjen e tyre është Gjykata ku ndodhet selia ligjore e shoqërisë.

Akti – Themelimit nënshkruhet rregullishtë, pa vërejtje, prej meje ortakut themelues.

PËR SHOQËRIN “MBJESHOVA 2011” SH.P.K.

ORTAKU I VETËM THEMELUES

GEZIM MEDULAJ

Gezim Medula



TAKSA E PULLES
U PAGUA
NE KOPJEN E AFSHIRYKUT



REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE BERAT
NOTERE ANDROMAQI BERATI
Nr. 960 Vep.
Nr. 480 Kol

VERTETIM NENSHKRIMI

Me ane te te cilit vertetoj se sot ne Berat me date 06 korrik 2011 , perpara meje noteres Andromaqi Berati, me zyre ne lagjen "10 Korriku" (perballe Gjykates se Rrethit) ne Berat u paraqit personalisht:

GEZIM MEDULAJ, i biri i Ramis dhe Dashuri , lindur ne Mbjeshove, Berat me 08.07.1972 dhe po aty banues, me zotesi te plote juridike per te vepruar, i panjohur prej meje noteres, me identitetin e te cilit une u sigurova konform Leternjoftimit Id numer 025789390.

... I cili ne prezencen time noteres , me vullnetin e tij te lire dhe nen pergjegjesine e tij personale nenshkroi rregullisht dokumentin e mesiperm : AKT THEMELIMI I SHOQERISE TREGTARE PRIVATE "MBJESHOVA 2011" shpk .

Une noterja e vertetoj ate.

NOTERE
Andromaqi BERATI